

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROKURIMEVE

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: “Blerje Karburanti për mjetet e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit për vitin 2026-2027”

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): NAFTE 09134000-7

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-95093-07-31-2026

Vlera e fondit limit: 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76,82 dhe 83 të LPP si dhe nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejen e Tregëtimit të Karburanteve, në përputhje me Ligjin Nr. 8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”. i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 970, date 02.12.2015

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162 , datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, 40 pika 5/a të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 970, datë 02.12.2015.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për tregëtimin e lëndës objekt prokurimi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të çertifikuar nga organet tatimore ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet

drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kriteri është vendosur duke u bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit të Prokurimit Publik (i ndryshuar), të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2026 sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2026)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2d), Pasi cdo operator ekonomik duhet të ketë të paguara taksat dhe tarifat vendore prane njesive të qeverisjes vendore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 1 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 LPP, neni 40, pika 4 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 55, pika 4, b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Raport Analizimi për tregun e brendshëm për cilësinë e produktit të kërkuar - Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, jo më përpara se tremujori i katërt i vitit 2025.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 pika 6 gërma c,) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me standartet teknike të kërkuara

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga I.SH.T.I. ose organet e tjera kompetente që të provojë se ka importuar dhe/ose ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2025 dhe deri në datën e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, nenin 40, pika 6, gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton që OE ofron cilësi duke respektuar standartet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar produkt sipas standardeve bashkëkohore. Vërtetimi i lëshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

2.3.4 Bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm” i ndryshuar, Operatoret ekonomik pjësemarrës duhet të ofrojne një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur ne perputhje dhe ne zbatim me VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem” i ndryshuar.

Kerkesa per disponimin e nje website te furnitorit eshte e rendesishme pasi furnizimi i karburantit me karte elektronike, transferimi i sasise se karburantit nga furnitor tek AK-ja behet ne menyre elektronike, vetem nepermjet website të furnitorit.

2.3.5 Operatori ekonomik fitues detyrimisht duhet të disponojë minimumi 2 (dy) pika shpërndarje karburanti në rrethin e Tiranës, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie, kontratë noteriale qeraje/furnizimi, ose të jenë të pasqyruara ne ekstraktin e QKB, etj), si dhe të dorëzojë një listë të pikave të karburantit me adresa të sakta të cilat do të shërbejnë për furnizimin e makinës së institucionit ose marrveshje me të tretët nëse ka.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur bazuar ne nenin 77 te ligjit nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar; nenit 40 pika 8 te VKM-së Nr.285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur në funksion të garantimit të realizimit me sukses të kontratës dhe përmbushjes së nevojave operative të Autoritetit Kontraktor

2.3.6 Të gjitha stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- a) Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;
 - b) Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL;
 - c) Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
 - d) Certifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
 - e) Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitjeve me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit te vlefshmërisë me datën e hapjes se ofertave;
-

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 ‘Për prokurimin publik’, nenit 40 pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, të ndryshuar, ky kriter është vendosur për të vertetuar që operatori ekonomik ofron kushtet e domosdoshme të sigurse dhe ushtrone veprimtarin sipas ligjeve për tregtimin e karburanteve.

Furnizimi do të bëhet çdo ditë për 24 orë pa ndërprerje, sipas nevojave të AK, me anë të kartave elektronike të personalizuar të automjeteve.

- Sasia e ngarkuar në sistemin elektronik do të shpërndahet nëpër kartat elektronike për secilin automjet sipas nevojave të AK.
- AK, do të ndjekë sistematikisht, nëpërmjet sistemit elektronik konsumin e karburantit për secilin automjet.
- Nga ana e OE kontraktor, në fund të muaji gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, do të kryhet llogaritja e sasisë së karburantit (gazoil) të tërhequr nga automjetet e AK me kartë elektronike pranë pikave të furnizimit me karburant dhe do të faturohet (me faturë tatimore) sasia e konsumuar.
- Fatura tatimore do të shoqërohet gjithmonë me pasqyrat analitike të përlllogaritjes së çmimeve të karburantit, në varësi të marzhit të fitimit të përcaktuar si dhe çmimin e bursës në ditën para lëshimit të faturës, të publikuar nga APP pas dërgimit të këtij çmimi për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, levruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe të konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të ditës para lëshimit të faturës
- OE duhet t’i ofrojë AK mundësinë e menaxhimit elektronik të furnizimit me karburant nga vetë institucioni AK. “User Name” dhe “KOD të veçantë identifikimi” për përdorimin e sistemit nga persona të autorizuar pranë AK.
- Në listën e automjeteve të Autoritetit Kontraktor janë 17 automjete, që duhet të pajisen me Kartë Elektronike të personalizuar, për t’u furnizuar me karburant.
- Për ndryshime (shtesë apo pakësim) në listën e automjeteve, autoriteti kontraktor do të njoftojë me shkrim Operatorin Ekonomik për të bërë ndryshimet e nevojshme

Argumentimi i specifikimeve teknike

Vendosja e Specifikimeve teknike për lëndën djegëse Gasoil është bërë në përputhje me Standardet Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së

përgjithshme të Standardeve, Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikujt e kërkuar karburant (dizel), përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

SHËNIM: Referuar Nenit 45, pika 2.1 të VKM RPP Nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, ku parashikohet:

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur ofertaekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithëkohës së zbatimit të kontratës.

APP publikon çmimet e bursës së dërguar për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Grupi i punës për përcaktimin e fondit limit, i ngritur me anë të urdhrorit të brendshëm nga titullari i AK, ka testuar tregun dhe ka mbajtur procesverbalin mbi vendosjen e fondit limit për procedurë me objekt: “Blerje Karburanti për mjetet e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë për vitin 2026-2027”

Në përcaktimin e fondit ka mbajtur në konsideratë normat e fitimit të shprehura në vlerë absolute (e cila mbetet e pandryshuar) të ofertave të marra gjatë testimit të tregut, ndërsa për elementët e tjerë të ofertës është mbështetur në Nenit 45, pika 2.1 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Njesia e Prokurimit